

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

Nr. / Br. 17876/26

Nr. i fq. / Br. st. -4-

Data: / Datum: 29.04.2026

VUSHTRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Komuna e Vushtrrisë  
Opština Vuçitrn – Municipality of Vushtri



**Kuvendi i Komunës**

**01 Nr. PB 70/26, 28.04.2026**

**PROCESVERBAL**

**nga mbledhja e tretë e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 23 mars 2026 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:05.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Kushtrim Hyseni, Xhon Gubetini, Blerina Shala, Fatmire Cecelia, Ymer Haradinaj dhe Gentiana Rama (anëtarë të KPF -së).

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë. Ajo tha se na ka ardhur edhe një pikë shtesë për ta shtuar në rend të ditës:

- Propozim - vendim për aprovimin e kandidatëve për Komision për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve.

***Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë pikë që të shtohet në rend të ditës.***

***Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:***

**R E N D D I T E**

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 23.02.2026;
2. Raport për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2025;
3. Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2025/2026;
4. Raport lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm;
5. Informatë lidhur me ofrimin e shërbimeve nga Drejtoria për Administratë për vitin 2025;
6. Propozim - vendim për aprovimin e kandidatëve për Komision për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve.

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 23.02.2026.

***Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 23.02.2026.***

2. Raport për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2025.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së** – sa i përket këtij raporti, shihet qartë dhe dëshmohet që Komuna e Vushtrisë nuk ka arritë t'i realizojë dhe të implementojë punët dhe projektet të cilat i ka pasë të planifikuara. Sigurisht që me këtë ka ndikuar edhe gjendja ekonomike, respektivisht ajo që për vite, kryetari i komunës po arsyetohet se kontrata kolektive e arsimit ka ndikuar negativisht (pra marrja e mjeteve).

Tek faqja 9, shihet se vetëm fermerëve ju ka mbetur borxh edhe për vitin 2024, 2025, po ashtu planifikimi për vitin 2026 është mjaft i rëndësishëm. Nëse i llogarisim këto tri vite, 278 mijë euro janë vetëm për fermerë, për subvencionimin e qumështit, komuna e Vushtrisë ka 834 mijë euro borxh (një shumë jashtëzakonisht e madhe). Nëse arsyetohemi që ka kalu viti 2025 dhe nuk kanë mundur me i realizu këto mjete, nuk e di qysh do të arsyetohet kryetari i komunës dhe qeveria komunale për mospagesën e pesë centit apo gjashtë centit, sa është për fermerët dhe bujqit e Vushtrisë, të cilët punojnë në kushte mjaft të rënda.

Do të ndalem shumë shkurt edhe tek e Drejtoria e Arsimit, tek raporti. Unë e di që drejtoresha është këtu dhe e ka marrë mandatin jo në kohën kur është bërë ky raport, por sigurisht ose janë gabime teknike, ose gabime përmbajtjesore. Te faqja 19, tek orët mësimore të planifikuara, po del që më shumë orë mësimore janë të mbajtura sesa orë të planifikuara. Ose janë gabime teknike, ose gabime përmbajtjesore. Të planifikuara janë 320738, të mbajtura janë 325329 dhe të pa mbajtura 459. Pra, kemi një disproporcion jashtëzakonisht të madh.

Faqe 27, tek sukcesi i nxënësve, shkolla fillore “Jusuf Gërvalla” në Dumnicë, thuhet se kalueshmëria është 0.41 (përqind), tek meshkujt 0.40, kurse te femrat 0.42, mendoj se nuk është gabim teknik. Pastaj, shkolla fillore “Bajram Curri” në Dumnicë, kalueshmëria është 0.49 (përqind), tek meshkujt 0.59, kurse te femrat 0.43. Nuk e di a është gabim teknik, por nëse është kalueshmëria e tillë, atëherë as nuk ja vlen me diskutu për këto shkolla.

Në SHFMU në Pestovë ka një kalueshmëri prej 97.31, ku 88.42 janë meshkuj, kurse 113.31 femra, qysh ka mundësi kjo?

Në faqe 31, tek numri i paraleleve kur janë mbledhë ka dalë 642 paralele, a në fakt janë 617 paralele, 25 paralele më pak.

Ai kërkoi që këto gabime të përmirësohen për seancën e kuvendit.

***Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të përmirësohen disa gabime dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

3. Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2025/2026.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së** – lidhur me numrin e punëtorëve në faqen 4, thuhet se janë 1147 punëtorë, kurse kur mblidhen del 1148. Ndoshta është gabim teknik.

Tek numri i institucioneve publike, thuhet që janë 38 institucione, nëse i numërojmë dalin 39 institucione.

Tek numri i institucioneve private, thuhet që është një shkollë e mesme e mjekësisë. Ai kërkoi që në informatë të përfshihen: Numri i nxënësve, suksesi i nxënësve, çfarë drejtimesh (profile) ka kjo shkollë?

Po ashtu, gjendja e sigurisë në shkolla – të përshkruhet në informatë, sepse nuk është thënë asnjë fjalë.

Në faqen 6, thuhet që disa aktivitete janë në fazën finale procesi i harmonizimit të kontratave të punës me punëtorët e arsimit, me legjislacionin në fuqi, ndonëse dish sa shkolla ende nuk i kanë harmonizuar ato. Pra, kjo i bie që disa shkolla ose nuk kanë kontrata fare, ose janë duke punuar me kontrata të vjetra, cila është arsyeja?

Pse punëtorët e arsimit, konkretisht këto shkolla nuk i kanë harmonizuar kontratat?

A i bie që janë duke pa kontrata? A është kontrata e dëmshme apo ka ndonjë specifikë që punëtorët e arsimit nuk janë të pajtimit me i nënshkruar këto kontrata?

Ai kërkoi që të përmirësohen dhe plotësohen për seancën e kuvendit.

***Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të përmirësohen disa gabime, si dhe të bëhen disa plotësime dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

4. Raport lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – tha se kryetari duhet të sigurojë kontroll efektive dhe komunikim mes drejtorive. Kjo është diçka që e kemi parë edhe ne se nuk ka kurrfarë koordinimi mes drejtorive të komunës. Edhe auditori e paska dhënë si rekomandim që me pasë planifikime sa më të mira.

Rekomandimi tjetër është se kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në mënyrë që të sigurojë planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve në ndarjet adekuate të buxhetit në përputhje me planin kontabël. Kemi parë vitin e kaluar që nuk ka pasë kurrfarë përputhjeje as për shpenzime dhe as për planifikime, ku janë bërë planifikimet pa buxhet.

Rekomandim tjetër i auditorit është se kryetari duhet të sigurojë përforcimin e komunikimit në mes sektorit të financave dhe përfaqësuesit ligjor të komunës. Këtu po shihet që nuk ka kurrfarë koordinimi në mes Drejtorisë së Financave dhe Zyrës Ligjore.

Një rekomandim tjetër është se kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në mirëmbajtjen e regjistrave të llogarive të arkëtueshme në mënyrë që të mundësohet prezantimi i saktë dhe i plotë i tyre në PVF. Te çështja dobësim, në procedurën e prokurimit publik, e kemi thënë edhe më herët, prapë po e them që gati të gjitha janë të specifikuar në prokurimin publik, se kush ka me marrë tenderin, kush ka me fitu.

Tek çështja B – Mangësi në monitorimin e raportimeve nga përfituesi i subvencioneve, këtu po del që nuk janë raportuar subvencionet, përveç personave fizikë që u janë ndarë pa kurrfarë kriteri edhe bashkësisë islame. Edhe atëherë e kam thënë që bashkësia islame duhet t'i raportojë komunës për mjetet financiare që i merr. Shumë mirë që edhe auditori i paska rekomanduar që çdo muaj të sjell një raport.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së** – desha të ndalem te faqja 8, pika 9 - Mospagesa e rregullt të qirasë nga shfrytëzuesit e pronave publike. Pra, kemi shumë kontrata (kontrata e qirasë), pika 7.1 e specifikon se nëse qiramarrësi dështon të paguajë obligimet e papaguara, pra dështon në zbatimin e kushteve të kontratës, atëherë qiradhënësi e njofton qiramarrësin për mospërmbushjen. Nëse qiramarrësi nuk e përmirëson dështimin brenda pesëmbëdhjetë ditëve, atëherë kontrata e qirasë automatikisht do të konsiderohet se ka përfunduar. Pra, gjatë auditimit të llogarive të arkëtueshme për shfrytëzimin e pronave publike të komunës janë identifikuar mangësi në menaxhimin e kontratave me qiradhënësit dhe janë të

specifikuara. Për shkak të kohës unë nuk po dua t'i sepcifikojë, por janë disa kontrata të vitit 2017, me afat gjatësie për 7 vjet, që i bie se këto kontrata janë të skaduara. Pra, qiramarrësit e kanë shfrytëzu pronën e komunës, kurse komunës i kanë mbet borxh (në këtë raport është e specifikuar edhe puna e borxheve). Prandaj, shihet që kryetari dhe qeveria komunale nuk kanë arritë t'i inkansojnë mjetet të cilat qiramarrësit ju kanë borxh. Ndërsa, rekomandimi i auditorit është se kryetari duhet të sigurojë që të bëhen monitorime dhe të sigurohen raportet kthyesë. Pra, kryetari nuk ka punuar në këtë drejtim. Kërkojmë që komuna të bëj maksimumin që t'i vjelë këto borxhe. Kjo, sepse është interes edhe i komunës edhe i qytetarëve, që qiramarrësit për pronën që veç e kanë shfrytëzu edhe nuk i kanë paguar obligimet ndaj komunës.

***Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

5. Informatë lidhur me ofrimin e shërbimeve nga Drejtoria për Administratë për vitin 2025.

***Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të plotësohet dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

6. Propozim - vendim për aprovimin e kandidatëve për Komision për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së** – tha se në parim e mbështesim këtë pikë që të vjen për kuvend, sepse shohim që një numër i konsiderueshëm i shkollave ose janë ushtrues detyre të drejtorëve ose janë në përfundim. Shohim që janë disa shkolla pa drejtorë, andaj ne vetëm kërkojmë që procesi i rekrutimit të drejtorëve të jetë një proces i drejtë, i depolitizuar, të jetë në harmoni me ligjin dhe për drejtor të zgjedhim persona që janë meritorë që të udhëheqen në shkollat tona, sepse është një përgjegjësi shumë e madhe.

***Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të plotësohet dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

Mbledhja përfundoi në orën 10:30.

**Bujar Klinaku**

  
Procesmbajtës



**Melihate Basholli - Latifi**

  
Kryesuese e KK-së dhe KPF- së